



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 277/1 prot.

Tiranë, më 11.7.2024

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 17.7.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 661, datë 18.5.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Hoxha

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 19.6.2023, është njoftuar vendimi nr. 661, datë 18.5.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besnik Hoxha, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 661, datë 18.5.2023, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Hoxha.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 20.6.2023, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 19.6.2023, ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e tij datë 3.7.2023, çmon se vendimi nr. 661, datë 18.5.2023, është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer

Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me rezultatet e hetimit mbi kontrollin e kriterit të pasurisë, vlerësimin e aftësive profesionale, kriterin e figurës si dhe rastet e konstatuara të gjendjes së konfliktit të interesit apo gjetje të tjera, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, të datës 19.6.2023.

Sa më sipër, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të paraqitura në ankimin e datës 3.7.2023, Komisioneri Publik parashtron sa në vijim:

I. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Për pasurinë: godinë banimi 3-kate në Shkodër, nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

1.1 Në *D-Vett.*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Godinë banimi 3 kate, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 105,4 m², me sipërfaqe ndërtimi 88,2 m², me sipërfaqe totale të banimit 299 m², në Lagjen “***”, Shkodër. Legalizuar sipas Lejes së legalizimit nr.***, datë **.4.2015, në emër të Besnik Hoxha. Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***/*** datë **.8.2003 është blerë truall me sip. 52 m² nga e cila 52 m² ndërtesë (shtëpi banimi një kat) në vlerën 900.000 lekë, blerë nga shitja e apartamentit në shumën 1.400.000 lekë sipas kontratës së shitjes nr. ***/*** datë **.10.1997. Për periudhën 2003 – 2013 janë bërë investime mbi objektin ekzistues, në vlerën 5.007.548 lekë, me burim nga të ardhurat familjare.*

1.2 Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, dorëzuar në ILDKPKI në datë **.3.2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë shtëpi banimi 1-katëshe dhe kati i dytë në proces ndërtimi, me sipërfaqe 60 m², në Lagjen “***”, rr. “***”, nr. **, Shkodër. *Burimi i krijimit: Të ardhurat nga shitja e apartamentit të privatizuar në vlerën 1.400.000 lekë. Vlera: 1.100.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

1.3 Në *DV-2004*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtesë në shtëpinë ekzistuese të banimit kati I gjithsej 80 m² dhe kati II 80 m². Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese 1/2.*

1.4 Në *DV-2015*, personi i lidhur me subjektin znj. *** ** (bashkëshortja) ka deklaruar: *Banesa me sipërfaqe 58 m², me vendndodhje në Shkodër e deklaruar në vitin 2003 si banesë në ndërtim e sipër dhe me procedurë regjistrimi në vazhdim, me lejen e legalizimit nr. *** datë **.4.2015 është disponuar vërtetimi nga dokumenti hipotekor me nr. **, datë **.5.2015, ku rezulton me një sipërfaqe prej 105.4 m², nga të cilat 88.2 m² janë ndërtesë (3 kate). Nuk deklarohet vlera, ndërsa pjesa takuese deklarohet 50%.*

1.5 Lidhur me origjinën e kësaj pasurie, kohën e ndërtimit dhe kostot e saj, nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar:

1.5.1 Me kontratë shitblerje nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë **.8.2003, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasit ***, **, ***, dhe ***. **, pasurinë truall me sip. 52 m² nga e cila 52 m² është ndërtesë ndodhur në lagjen “***”, Shkodër.

1.5.2 Me anë të vetëdeklarimit nr. *** prot., datë **.7.2013, subjekti i rivlerësimit ka aplikuar për legalizimin e pasurisë godinë banimi 3-katëshe në Shkodër dhe me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.4.2015, për kalimin e pronësisë të parcelës ndërtimore, subjekti ka përfituar nga ALUIZNI, një parcelë ndërtimore me sipërfaqe 53,4 m², kundrejt shumës së paguar prej 38.448 lekë dhe bono privatizimi me vlerë nominale 55.000 lekë. Në vijim, ndërtesa informale është legalizuar sipas lejes së legalizimit nr. **, datë **.4.2015, për godinë banimi 3 kate, me sipërfaqe

totale ndërtimi 299 m², nga të cilat sipërfaqe e parcelës ndërtimore 105,4 m², kati përdhe me sipërfaqe 88,2 m², kati i parë dhe kati i dytë me sipërfaqe 105,4 m²/secili.

1.5.3 Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeo-hapësinor¹ ka përcjellë dokumentacion lidhur me këtë pasuri, nga ku është konstatuar se referuar parametrave të objektit, dukej se godina kishte përfunduar (së paku si lartësi/kate), në vitin 2007.

1.5.4 Banka *** (***) me shkresën nr. ***/* prot., datë **.8.2020, informon se kjo pasuri është hipotekuar në favor të bankës me kontratën e hipotekimit nr. ***/**, datë **.1.2013. Sipas deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se kredia për të cilën është hipotekuar kjo pasuri është marrë nga shtetasit ***, dhe ***, ***, sipas kontratës së kredisë nr. ***/**, datë **.1.2013, dhe nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se qëllimi i kredisë është për blerjen e një apartamenti nga kredimarrësit ***, dhe ***, ***, të ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me administrator dhe një ndër ortakët e kësaj shoqërie, znj. ***, ***,

1.6 Për sa i përket vlerës së pasurisë dhe kohës së investimit të saj, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ndër të tjera, ka deklaruar: “... ndërtimi i banesës ka zgjatur për vite të tëra nga viti 2003 në vitin 2007 ...”, ndërsa i pyetur lidhur me mosdeklarimin e investimit dhe shpenzimeve të kryera për ndërrimin e kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar “... nuk kam deklaruar vlerën prej 5.007.548 lekë pasi ajo ka qenë e shpërndarë ndër vite, pra kjo shumë nuk është shpenzuar brenda një periudhe të caktuar. Objekti ka qenë në ndërtim për afro 5 vite. Kati i parë i banesës ka qenë i ndërtuar në momentin që e kam blerë këtë pasuri në vitin 2003, ndërsa punimet për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë i kam filluar në vitin 2003 dhe kanë përfunduar në vitin 2007...”. Për sa i përket shpenzimeve për mobilimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar mobilim në vlerën rreth 300.000 lekë.

1.7 Për sa i përket burimeve të krijimit të pasurisë, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për blerjen e pasurisë godinë banimi të ndodhur në lagjen “****”, në Shkodër në vitin 2003. Ndërsa për ndërtimet e kryera në këtë pasuri pas blerjes, nisur nga deklaramet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve si dhe nga fotografimet ajrore të paraqitura nga Autoriteti Gjeo-hapësinor, Komisioni ka vlerësuar se duket se punimet e jashtme të ndërtimit kanë përfunduar në vitin 2007, duke përllogaritur kostot e ndërtimit të shtrira përgjatë periudhës deri në këtë vit (2007). Në mungesë të dokumentacionit të kohës për të provuar koston e ndërtimit, Komisioni ka kryer një përllogaritjet duke u bazuar në vlerat referuese sipas EKB-së për vitet 2004 – 2007 dhe duke zbritur nga to vlerat për fondin rezervë dhe fitimin e planifikuar, bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit.

1.8 Në përfundim, Komisionit i ka rezultuar vlera totale për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë të banesës në shumën 4.773.993 lekësh, në rast të analizimit të punimeve në periudhën 2004-2007 (ose 5.279.997 lekë nëse punimet do të shtriheshin deri në vitin 2013). Nisur nga përfaqësia e këtyre vlerave me vlerën e deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në Deklaratën “Vetting”, prej 5.007.548 lekë, Komisioni ka konsideruar këtë të fundit si kosto totale të ndërtimit të pasurisë.

1.9 Nisur nga sa ka rezultuar nga të dhënat e administruara, fotografimet ajrore të paraqitura nga Autoriteti Gjeo-hapësinor, deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike ndër vite dhe në përgjigje të hetimit administrativ, Komisioni ka vlerësuar, se mund të konsiderohet që ndërtimi i katit të dytë është kryer në vitet 2003 dhe 2004, ndërsa ndërtimi i katit të tretë është

¹ Referohuni informacionit të përcjellë nga ky institucion me shkresën nr. ***/* prot., datë **.12.2021.

kryer në vitet 2005 – 2007. Në vijim, nga analiza financiare Komisionit i ka rezultuar se për kryerjen e ndërtimit në fjalë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, përgjatë viteve 2004 – 2007, në shumën - 3.455.325 lekë².

1.9.1 Komisioni, në mënyrë alternative ka konstatuar gjithashtu, se edhe nëse do të konsiderohej dhe kryhej përllogaritja duke e shtrirë periudhën e ndërtimit në analizë, deri në vitin 2013 (referuar deklaramit të subjektit në Deklaratën “Vetting”), gjithsesi do të rezultonte një mungesë e përafërt e burimeve të ligjshme financiare prej - 3.298.417 lekë.

1.10 Nisur nga sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi: (i) *Duket se ka mospërputhje mes deklarameve të subjektit, sa i përket periudhës së ndërtimit të banesës, mes Deklaratës Vetting, ku përshkruhet periudha 2003 – 2013 dhe në përgjigje të pyetësorëve ku përmendet periudha 2003 – 2007;* (ii) *Duket se subjekti nuk ka deklaruar shpenzimet/investimet e kryera në lidhje me pasurinë godinë banimi 3-katëshe, përgjatë viteve 2003 – 2007;* (iii) *Duket se për ndërtimin e banesës në fjalë përgjatë periudhës 2003 – 2007 (sikurse është konfirmuar nga ortofotot), subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -3.455.325 lekë. Megjithatë, edhe nëse do të konsiderohej sipas deklaramit në deklaratën Vetting, gjithsesi do të rezultonte një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në masën -3.298.417 lekë;* (iv) *Duket jobindës pretendimi se mobilimi i një banese 3-katëshe të ketë kushtuar vetëm 300.000 lekë.*

1.11 Në përfundim Komisioni, pasi ka vlerësuar prapësimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *përgjithësisht këto shpjegime shkojnë në harmoni me deklaramin e tij në deklaramat periodike ndër vite. Ndonëse në përgjigje të pyetësorëve subjekti nuk ka qenë i saktë në përcaktimin e shpërndarjes në kohë dhe masës të shpenzimeve të kryera për ndërtimet shtesë në godinën e banimit në analizë, ky konfuzion apo kjo pasaktësi/mospërputhje në mungesë të një prove të kundërt, nuk mund të zerojë vlerën provuese të deklarameve të tij në DIPP-të e viteve 2003, 2004 etj. [...].*

1.11.1 Lidhur me pretendimin e subjektit për shtrirjen në kohë të shpenzimeve të kryera për ndërtimin e godinës së banimit 3-katëshe përtej vitit 2007, Komisioni ka rillogaritur koston e ndërtimit të dy kateve të para, në harkun kohor 2003 – 2004, e cila sipas EKB-së, ka rezultuar në vlerën 2.475.063 lekë, duke e konsideruar për vitin 2004 shumën prej 500.000 lekësh³ dhe përllogaritur pjesën e mbetur gjatë vitit 2003. Në këto kushte, Komisioni ka arsyetuar se: *duke i përllogaritur në mënyrë homogjene shpenzimet e ndërtimit për vitet e mëpasshme (deri në vitin 2007), për sa kohë nuk ka pasur ndonjë deklaram të këtij lloji në DV-të përkatëse të viteve 2005 dhe 2006, dhe as indicie mbi ndonjë shkak përqendrimi apo shpërndarje të ndryshme të tyre ndër vite, për periudhën 2003 – 2007, rezulton se subjekti i rivlerësimit për kryerjen e këtij ndërtimi, ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën - 1.440.037 lekë.*

1.11.2 Komisioni ka kryer edhe një përllogaritje alternative për kohën e kryerjes së shpenzimeve, duke mbajtur në konsideratë në këtë rast, deklaramin e bërë nga subjekti në Deklaratën “Vetting” lidhur me shpërndarjen e shpenzimeve për ndërtimin e katit të tretë deri në vitin 2013 (përfshirë këtu edhe pretendimet e tjera të sipërcituara, si dhe pretendimet e subjektit mbi shpenzimet e udhëtimit, siç do të trajtohen në vijim), nga e cila ka rezultuar pamjaftueshmëri financiare për

² Referohuni analizës financiare të paraqitur në f. nr. 10, të vendimit të Komisionit.

³ Sipas deklaramit vjetor në DV-në e këtij viti.

ndërtimin e pasurisë në fjalë, në masën -1.141.823 lekë, pamundësi kjo që sipas Komisionit, do të shtrihet për një hark kohor 10-vjeçar (2003 – 2013).

1.12 Në konkluzion të sa më sipër, Komisioni, nisur nga niveli i balancës negative të konstatuar në të dyja variantet e sipërpërshkruara (në vlerën rreth 1.1 milionë lekë apo 1.4 milionë lekë), duke mbajtur në vëmendje që kjo pamundësi do të zvogëlohet nëse do të përlllogariteshin të ardhurat e përfituara nga puna e subjektit si OPGJ, përgjatë periudhës 1991 – 1997, si dhe kryesisht duke u bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, ka vlerësuar se kjo pamjaftueshmëri financiare nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me aplikimin e pikës 3 të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016.

1.13 *Komisioneri Publik*, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, për vlerësimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë godinë banimi 3-kate të ndodhur në Shkodër, ndan gjykim të ndryshëm nga Komisioni, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës. Komisioni rezulton të ketë pranuar të gjitha deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, megjithëse ato paraqiten inkonsistente, jo të besueshme dhe të pa mbështetura në prova, duke përmbysur kështu analizën financiare dhe duke iu shmangur standardeve tashmë të pranuar të procesit të rivlerësimit.

1.13.1 Referuar deklaratave periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar investime/shpenzime të kryera për blerjen dhe ndërtimin e kësaj banese përkatësisht shumën 1.100.000 lekë në vitin 2003 dhe 500.000 lekë në vitin 2004, ndërsa nuk rezulton të ketë deklaruar vlerën e investimeve/shpenzimeve të kryera në vitet në vazhdim. Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratime kontradiktore lidhur me periudhën e ndërtimit të banesës, pasi në Deklaratën “Vetting” i referohet periudhës 2003 – 2013, ndërsa në përgjigje të pyetësorëve gjatë hetimit administrativ, deklararon se ndërtimi është kryer në vitet 2003 – 2007.

1.13.2 Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni në përfundim të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në të dyja variantet alternative të llogaritjes së shpenzimeve, si përgjatë viteve 2004 – 2007 në masën - 3.455.325 lekë⁴, ashtu dhe në variantin që do të konsiderohej shtrirja e periudhës së ndërtimit deri në vitin 2013, në masën -3.298.417 lekë⁵. Në vlerësimin përfundimtar, pasi Komisioni ka konsideruar zhvendosjen e një pjese të konsiderueshme të këtyre shpenzimeve në vitin 2003, bazuar vetëm në pretendimet e pa provuara të subjektit në përgjigje të barrës së provës, duke rishikuar dhe shpenzimet e udhëtimit, ka vlerësuar se këto diferenca negative janë reduktuar ndjeshëm.

1.13.3 Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i Komisionit për të llogaritur shpenzime për blerjen e objektit 1-katësh dhe për ndërtimin e kryer në vitin 2003, përkatësisht në vlerat 900.000 lekë dhe 1.975.063 lekë, është i pa bazuar në provat e administruara. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, investimi/shpenzimi i përfshirë në analizën financiare të viti 2003, duhet llogaritur në vlerën 1.100.000 lekë, sikurse është deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2003, për sa kohë nuk është administruar një dokument ligjor i kohës që provon të kundërtën dhe shpërndarja e kostove të ndërtimit duhet të kryhet për periudhën në vijim. Në këtë vlerësim,

⁴ Referohuni analizës financiare të paraqitur në f. 10, të vendimit të Komisionit. Sipas kësaj analize, konstatohet se shpenzimet e jetesës për vitin 2007, nuk janë llogaritur sipas standardit të përdorur nga ILDKPKI/INSTAT, ç’ka do të thellonte me tej diferencën negative të konstatuar.

⁵ Në këtë analizë nuk përfshihet pamjaftueshmëria e konstatuar lidhur me mundësinë e huadhënësit *** ** për huan e dhënë subjektit të rivlerësimit në vitin 2011, sikundër do të trajtohet në vijim, detyrim i cili, referuar deklaratimeve të subjektit, është mbyllur brenda vitit 2011.

Komisioneri Publik mban në konsideratë edhe jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit lidhur me vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore. Edhe në konsideratë të llogaritjes së kostove të ndërtimit në vitin 2004 në shumën 500.000 lekë, sikundër deklaruar nga subjekti në DV-2004, rishpërndarja e kostove për periudhën në vijim (si për 2005-2007, ashtu dhe për 2005-2013), do të thellonte pamjaftueshmërinë financiare për këto vite.

1.13.4 Sjellim në vëmendje këtu dhe faktin, se nga aktet në dosje rezulton se godina njëkatëshe ekzistuese është blerë nga subjekti në muajin *Gusht* të vitit 2003, dhe pretendimi i subjektit se pjesa më e madhe e investimit për katin e parë dhe të dytë, duhet llogaritur si shpenzime të këtij viti, përveçse bie ndesh me deklaratën e vitit 2003 (ku deklarohet vlera e pasurisë në shumën 1.100.000 lekë), duket gjithashtu logjikisht dhe praktikisht e pamundur që për një periudhë katër mujore të jetë investuar shtesa e katit përdhe dhe ndërtimi i katit të parë. Ky pretendim i subjektit, vetëm pas kalimit të barrës së provës dhe konstatimit të diferencave negative, për të konsideruar investimin/shpenzimin e kryer në vitin 2003 në një vlerë më të lartë nga sa deklaruar, duket si një përpjekje e tij për të reduktuar diferencën negative të konstatuar nga Komisioni për vitet në vijim. Këto pretendime të subjektit të rivlerësimit nuk provohen as nga pamjet e marra nga *Google earth*, akte të sjella nga vetë subjekti pas kalimit të barrës së provës, për të mbështetur pretendimin e tij se shtesa e katit të dytë është ndërtuar në pjesën më të madhe gjatë viti 2003. Ky akt i vënë në dispozicion nga subjekti nuk përmban një datë të saktë të kohës që i referohen këto pamje satelitore, me qëllim provimin e situatës faktike të pretenduar prej tij.

1.13.5 Gjithashtu, lidhur me koston e ndërtimit të objektit godinë banimi trekatëshe, nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se nuk janë përfshirë në llogaritje kostot për ndërtimin e shtesës së katit përdhe, (nga 52 m² në 88 m²), çka do të rezultonte në një vlerë më të lartë të investimit të kryer nga subjekti duke thelluar diferencën negative të konstatuar. Referuar Rekomandimit të ONM-së, kostot e ndërtimit/investimit llogariten në vlerën totale prej 5.627.517,41 lekë, sipas variantit të parë (ndërtimi në vitet 2003-2007) dhe në vlerën 5.858.577,58 lekë, sipas variantit të dytë (ndërtimi në vitet 2003-2013).

1.13.6 *Komisioneri Publik*, gjithashtu, e gjen të pambështetur dhe jo të provuar edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, shpenzimet për mobilimin e një godine banimi me sipërfaqe 299 m² kanë qenë në shumën 300.000 lekë. Kjo vlerë, e pretenduar si shpenzim i kryer nëpërmjet blerjeve në tregun e “mobileve të përdorura”, e pa shoqëruar me asnjë akt provues, qoftë edhe në nivelin e një indicie, duket jo e vërtetë dhe tepër e ulët.

1.14 Sa më sipër, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në të gjitha variantet alternative të shpërndarjes së shpenzimeve dhe kryerjes së analizës financiare mbi ndërtimin e pasurisë në fjalë (si 2003-2007 ashtu dhe 2003-2013), ndodhen në kushtet e deklaratimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë “*Godinë banimi trekatëshe*” ndodhur në Shkodër, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, duket se nuk gjen zbatim aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga ana e Komisionit, pasi pamjaftueshmëria financiare e konstatuar në rastin konkret, nuk është në masën/vlerën që të mund të gjejnë zbatim këto parime të aplikuara deri tani në jurisprudencën e Kolegjit, gjatë kontrollit të kriterit të pasurisë. Duke mbajtur në konsideratë edhe elementë të tjerë të konstatuar për rastin, nisur nga përmbajtja e nenit 4 pika 5, të ligjit nr. 84/2016, është e qartë se parimi i proporcionalitetit nuk mund të merret dhe interpretohet i shkëputur për relativizuar pasaktësinë në deklaram dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme në krijimin e pasurisë godinë banimi 3-kate të ndodhur në Shkodër, duke u shmangur kështu, nga detyrimi për deklaram me vërtetësi të tërësisë së pasurisë dhe shpjegimit bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj.

2. Për pasurinë: apartament banimi, rr. “*** **”, Tiranë, nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

2.1 Në D.-Vett., në seksionin “Të dhëna konfidenciale” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit datë **.8.2010 me shtetasen *** ** i kam lënë në përdorim banesën time në Shkodër në këmbim të banesës në Tiranë; (ii) Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit datë **.2.2016 me shtetasen *** ** i kam lënë në përdorim banesën time në Shkodër në këmbim të banesës në Tiranë. Në faqen 4 të Deklaratës “Vetting”, në seksionin ku kërkohet të deklarohet: “Nëse dispononi vendqëndrim tjetër”, subjekti ka deklaruar si adresë dytësore rr. “*** **” Tiranë.

2.2 Subjekti i ka bashkangjitur dokumentacionit të dorëzuar pranë ILDKPKI-së dhe dy marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar me znj. **, respektivisht:

(i) Marrëveshje bashkëpunimi (shkëmbim qiraje) datë **.8.2010, dokument i thjeshtë me vërtetim nënshkrimi noterial të datës **.10.2011, midis palëve, **, **, e cila disponon një apartament sipas vërtetimit të pronësisë me nr. ** datë **.10.2006, me nr. pronësie */** nr. **, kati * banimi me sip.135 m², dhe subjektit të rivlerësimit i cili disponon një banesë private ndodhur në Shkodër me adresë “***”. Palët kanë rënë dakord të marrin me qira pronat e njëri tjetrit pa kundërshtim.

(ii) Marrëveshje bashkëpunimi datë **.2.2016, dokument i thjeshtë me vërtetim nënshkrimi noterial të datës **.03.2016, midis palëve, **, **, e cila disponon një apartament me nr. pasurie */** me sip. 145 m² z. k. **, ndodhur në Tiranë me adresë Rr. “*** **”, dhe subjektit të rivlerësimit, i cili disponon një banesë private ndodhur në Shkodër me adresë “***”. Palët kanë rënë dakord të marrin me qira pronat e njëri tjetrit pa kundërshtim.

2.3 Në deklaratat periodike 2010-2015⁶, subjekti ka deklaruar si adresë të vetme banimi : *Lagja “***”, rr. **, nr. **, Shkodër*. Në DV – 2016, në seksionin ku kërkohet të deklarohen adresat e banimit, subjekti ka deklaruar si adresë të dytë banimi, Rr. “*** **”.

2.4 Sikundër detajuar gjerësisht në ankim, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka dhënë shpjegime në Komision lidhur me adresat e banimit për periudhën nga emërimi pranë Gjykatës Tiranë e në vijim⁷.

⁶ Në DV-2014, nuk rezulton të jetë deklaruar adresë në seksionin përkatës.

⁷ Në përgjigje të pyetësorit *standard* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Në vitin 2010 jam transferuar me detyrë Gjyqtar në Gjykatën e Tiranës por kam vazhduar të jetoj në qytetin e Shkodrës deri në 2015. Në vitin 2016 jam transferuar së bashku me familjen në qytetin e Tiranës në banesën e ndodhur në rr. “*** **”, pallati ** shtëpi e znj. ** sipas marrëveshjes së datës **.2.2016. Nga viti 2018 e deri më sot jetoj në banesën e ndodhur në rr. “*** **”, sh. *, kati *, ap. *, në pronësi të shoqërisë “***” sh.p.k., kjo e rregulluar me kontratën e qirasë nr. ** rep., nr. ** kol., dt **.1.2018, lidhur përpara noteres **, **.”; Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*** ** ka pasur marrëveshje verbale me shoqërinë **. Në vitin 2010 kemi rënë dakord me znj. ** për shkëmbimin e banesave. Në këto kushte kam vijuar të jetoj në Shkodër deri në fund të vitit 2015 dhe në fillim të vitit 2016 jam transferuar së bashku me familjen në qytetin e Tiranës për banim. Ndërsa, në përgjigje të pyetjes së Komisionit mbi arsyen e përdorimit të banesës së znj. **, subjekti i rivlerësimit në të njëjtin pyetësor, deklaroi: “Nuk kam asnjë lidhje me shtetasen **. Përdorimi ka ardhur si pasoje e shkëmbimit të banesave nga “***” sh.p.k.”, duke saktësuar se bëhet fjalë për të njëjtin apartament; Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, i pyetur nga Komisioni mbi arsyet e vazhdimësisë së qëndrimit në apartamentin me adresë Rr. “*** **”, pavarësisht faktit të ndryshimit të pronarëve (disa herë), subjekti është përgjigjur se: “*** ** ka pasur marrëveshje me shoqërinë “***” sh.p.k. Në vitin 2010 kemi rënë dakord me znj. ** për këmbimin e banesave. Në këto kushte kam vijuar të jetoj deri në fund të vitit 2015 në banesën time në Shkodër dhe në fillim të vitit 2016 jam transferuar së bashku me familjen time në Tiranë për banim. Apartamenti i cili pas prishjes së kontratës së porosisë nga z. ** ** është blerë nga shtetasja ** **. Në bazë të marrëveshjes sime me shtetasen ** ** kam filluar të jetoj në këtë apartament në vitin 2016.

2.5 Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se në datë **.1.2011, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e porositësit ka nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, një kontratë porosie me nr. *** rep. nr. *** kol., për një apartament (3+1) me sipërfaqe 147.05 m² +19.87 m² në adresën rr. “**** ****”, në shumën prej 225.342 euro. Kjo marrëdhënie kontraktuale, pagesat e kryera për qëllim të saj si dhe burimi i ligjshëm i tyre, nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DV-2011 dhe atë “Vetting”.

2.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me sa më sipër konstatuar, subjekti i rivlerësimit deklaroi për herë të parë një marrëdhënie huaje me shtetasin *** ***, konkretisht: “... sqaroj se arsytet e mosdeklarimit në DV- 2011 të Kontratës së Porosisë dhe kontratës për marrje huaje, ka ardhur për shkak se huaja është marrë në fillim të vitit 2011 si dhe për shkak të mos pamundësisë financiare për shlyerjen e kësaj huaje, kam hequr dorë nga Kontrata e Porosisë. ... Sqaroj se në datën **.1.2011 i kam marrë hua z. *** **** 107 mijë euro, shumë të cilën e kam paguar për blerjen e apartamentit të porositur me Kontratë Porosie nr. ***/*** datë **.1.2011, e lidhur nëpërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. në cilësinë e investitorit dhe z. B. Hoxha në cilësinë e porositësit. Objekti i kontratës është porosia e një apartamenti banimi me sip. 147,05 m² në vlerën totale 225.342 euro. Shuma prej 75.000 euro si pjesë e kështit të parë është paguar në dorë në datën e nënshkrimit të kontratës. Pjesa tjetër e kështit të parë brenda 15 ditëve. ... Në kushtet kur shuma për tu kthyer ishte shumë e lartë dhe afati i parashikuar ishte i shkurtër, e kisha të pamundur kthimin e shumës tek huadhënësi. Për këtë arsye duke u dakordësuar me z. *** **** dhe me shoqërinë sipërmarrëse, hoqa dorë nga blerja e apartamentit duke e kaluar tanimë te huadhënësi në cilësinë e porositësit të apartamentit. Nuk ka asnjë detyrim ndaj huadhënësit dhe shoqërisë dhe kjo provohet nëpërmjet deklaratës së lëshuar nga z. *** në muajin dhjetor 2011. Gjithashtu është zgjidhur marrëdhënia e porosisë me shoqërinë sipërmarrëse, provuar me deklaratë noteriale ***/*** datë **.12.2011... palët deklarojnë se pagesa e kryer nga Besnik Hoxha kalon në favor të blerësit të ri të apartamentit z. *** në vlerën prej 107.500 euro⁸.”

2.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësit *** ***, për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit shumën 107.500 euro, subjekti ka deklaruar se: “... si burim kanë shërbyer të ardhura nga shitja e pasurive, të ardhura nga emigracioni si dhe nga një

Dhe pasi shtetasja *** *** e ka shitur apartamentin tek shoqëria “****” sh.p.k., me këtë të fundit kam rënë në dakordësi të lidh kontratë qiraje dhe të vazhdoj të jetoj po në këtë apartament”; në përgjigje të pyetësorit nr. 4 , ka deklaruar se: “... transferimi i familjes në qytetin e Tiranës ka ndodhur fizikisht në vitin 2016. Regjistrimi pranë njësisë administrative nr. *, është bërë vetëm shkresërisht në kuadër të transferimit të ardhshëm në vitin 2016”; në përgjigje të pyetësorit nr. 5, lidhur me përdorimin e apartamentit të znj. ***, subjekti ka deklaruar se: “... sqarojmë se pallati në Tiranë në vitin 2010 nuk ka qenë ende i banueshëm dhe kontrata do të bëhej efektive kur ai pallat të përfundonte dhe unë të mund të banoja në Tiranë. Lidhja e kontratës ka qenë konkluzioni i bisedës formale me interes të përbashkët e cila u vonua të realizohej, për shkak të vonësës së ndërtimit të pallatit. Gjithsesi unë gjithmonë kam qenë me shpresën se do isha me banim në Tiranë”.

⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka vënë në dispozicion: (i) kontratë huaje të panoterizuar, dt **.1.2011 lidhur midis subjektit si huamarrës dhe z. *** *** si huadhënës; (ii) kontratë porosie nr. ***/***, datë **.1.2011, lidhur midis palëve shoqëria “****” në cilësinë e investitorit dhe subjektit në cilësinë e porositësit; (iii) deklaratë e thjeshtë e shtetasve z. *** *** dhe subjektit të rivlerësimit, në të cilën deklarohet se ky i fundit, duke qenë në pamundësi për të kthyer huan e marrë sipas kontratës datë **.1.2011 (përdorur për porositjen e apartamentit nga shoqëria “****”), palët bien dakord që z. *** të bëhet titullar i të gjitha të drejtave mbi apartamentin e porositur nga subjekti; (iv) deklaratë noteriale nr. ***/***, datë **.12.2011, me deklarasë shoqëria “****”, z. *** dhe subjekti i rivlerësimit, në të cilën deklarohet se zgjidhet kontrata e porosisë nr. ***/*** e datës **.1.2011, dhe për këtë apartament shoqëria “****” do të lidhë kontratë paraprake me *** *** për të njëjtën çmim shitje. Pagesa e bërë nga subjekti i rivlerësimit i kalon në favor të *** ***. ...; (v) Kontratë paraprake shitje nr. ***/***, të datës **.12.2011, lidhur midis shoqërisë “****” në cilësinë e palës shitëse dhe *** *** në cilësinë e palës blerëse; (vi) deklaratë noteriale nr. ***/*** datë **.5.2012, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., dhe z. *** sipas së cilës një pjesë e shumës tërhiqet nga administrator i shoqërisë dhe do ti kthehet z. ***; (vii) Deklaratë noteriale nr. (i palexueshëm), datë **.1.2016, me deklarasë shoqëria “****” sh.p.k. dhe z. *** në të cilën deklarohet se kontrata paraprake e shitjes nr. ***/*** datë **.12.2011, është zgjidhur që në maj të vitit 2013.

kredi bankare marrë nga ky shtetas pranë *** Bank⁹”. Në të njëjtin pyetësor, lidhur me kërkesën e Komisionit për vënien në dispozicion të akteve provuese për kthimin e pagesave për porositjen e apartamentit nga shoqëria “****” sh.p.k. tek z. *** ***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk disponon prova të tjera përveç deklaratës noteriale me nr. ***/*** datë **.6.2022.

2.8 Komisioni ka administruar nga ASHK¹⁰, dokumentacionin që i përket pasurisë me nr. */***+*-* ndodhur në zk ***, me adresë rr. “**** ****”, pasuri e cila, nga hetimit administrativ ka rezultuar në posedim dhe gëzim të subjektit të rivlerësimit, aktualisht e poseduar prej tij në cilësinë e qiramarrësit, sipas kontratës së qirasë nr. *** rep., nr. ** kol., dt. **.1.2018, nënshkruar me qiradhënësin, shoqërinë “****” sh.p.k. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja, lidhur me këtë pasuri, kanë rezultuar këto veprime juridike dhe kontrata, në rend kronologjik si më poshtë:

(i) Në datën **.12.2010, është nënshkruar kontrata noteriale e porosisë nr. ***/***, ndërmjet ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., z. *** ***, në cilësinë e ndërtuesit dhe znj. *** ***¹¹, në cilësinë e porositëses, për një apartament në rrugën “**** ****”, identifikuar në hyrjen nr. *, apartamenti nr. *, për shumën 19.720.000 lekë;

(ii) Në datën **.8.2013, është nënshkruar kontrata noteriale e porosisë nr. ***/***, ndërmjet znj. *** ***, në cilësinë e shitëses (duke deklaruar si palë, se në momentin që do bëhet pronare e ligjshme do të lidhë kontratën e shitjes) dhe znj. *** ***, në cilësinë e palës blerëse, për një apartament në rrugën “**** ****”, identifikuar në hyrjen nr. *, apartamenti nr. *, për shumën 19.720.000 lekë;

(iii) Në datën **.9.2013, është nënshkruar kontrata noteriale e shitjes nr. ***/***, ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori z. *** ***, në cilësinë e palës shitëse dhe në cilësinë e palës blerëse, po z. *** si individ, me objekt, pasurinë e regjistruar me nr. */***+*-*, ZK nr. ***, apartament me sip. 145 m², identifikuar në hyrjen nr. *, (ap.) nr. *, kati *, për shumën 14.500.000 lekë;

(iv) Në datën **.11.2015, është nënshkruar kontrata noteriale e shitjes nr. ***/***, ndërmjet z. *** ***, në cilësinë e palës shitëse dhe znj. *** ***, në cilësinë e palës blerëse, me objekt, pasurinë e regjistruar me nr. */***+*-*, z. k. nr. ***, apartament me sip. 145 m², identifikuar në hyrjen nr. *, apartamenti nr. *, për shumën 19.720.000 lekë;

(v) Në datën **.1.2016, është nënshkruar kontrata noteriale e shitjes nr. ***/***, ndërmjet znj. *** ***, në cilësinë e palës shitëse (duke deklaruar si palë, se në momentin që do bëhet pronare e ligjshme do të lidhë kontratën e shitjes me palën blerëse), dhe znj. *** ***, në cilësinë e palës blerëse, për apartamentin e ndodhur në Rr. “**** ****”, identifikuar në hyrjen nr. *, apartamenti *, për shumën 19.720.000 lekë;

(vi) Në datë **.12.2017, është nënshkruar kontrata noteriale e shitjes nr. ***/***, ndërmjet znj. *** *** në cilësinë e palës shitëse, përfaqësuar me prokurë nga z. *** ***¹² dhe kompanisë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës blerëse, përfaqësuar nga administratori z. *** ***, me objekt, pasurinë

⁹ Subjekti ka listuar: (i) kontratë shitblerje ***/***, datë **.12.2003, në vlerën 1.900.000 lekë; (ii) kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.9.2006, me vlerë 500.000 lekë; (iii) kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.5.2004, me vlerë 1.000.000 lekë; shuma e kredisë prej 50.000 euro marrë pranë *** Bank, datë **.10.2010; (iv) vlera prej 28.886,86 euro të ardhura nga emigracioni në shtetin Italian.

¹⁰ Me shkresën nr. ***/* prot., datë **.8.2022.

¹¹ E cila referuar gjeneraliteteve në kontratë rezulton e ëma e investitorit *** ***.

¹² Në **.06.2017, *** *** nëpërmjet një prokure i kalon të gjitha të drejtat për të vepruar në emër të saj, lidhur me këtë apartament, z. *** ***. *** *** është i vëllai i *** ***.

e regjistruar me nr. */***+*-*, z. k. nr. ***, Rr. “**** **”, apartament me sip. 145 m², identifikuar në shk. *, kati i *, apartamenti nr. *, për shumën 19.720.000 lekë (147.390 euro).

2.9 FSHU, për këtë pasuri, ka bërë me dije se kontrata e furnizimit me energji elektrike me nr. ***, është çelur fillimisht në datë ** .11.2012, nga abonenti *** ***. Më pas, në datë **.7.2018, është ndryshuar emri i abonentit, duke kaluar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

2.10 UKT, me shkresë nr. ***/* prot., datë **.6.2022, ka bërë me dije se kontrata e furnizimit nr. ***-*, është çelur në muajin mars 2013, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

2.11 Përpos akteve të mësipërme, administruar nga institucionet shtetërore si ASHK, FSHU dhe UKT, si dhe kontratës së porosisë datë **.1.2011 nr. ***/***¹³, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, për pasurinë apartament me adresë rr. “**** **”, nga aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, kanë rezultuar dhe:

(i) Kontratë huaje e datës **.1.2011, në formë shkresore të thjeshtë (jo noteriale), nënshkruar ndërmjet z. *** *** dhe subjektit të rivlerësimit z. Besnik Hoxha, ku rezulton fakti se z. Tahiri do të japë hua subjektit të rivlerësimit shumën prej 110.000 euro, në dy këste, respektivisht: (a) 75.000 euro brenda datës **.1.2011 dhe (b) 35.000 euro deri më datë **.1.2011. Shuma duhet të kthehej nga huamarrësi deri më datë **.1.2016, pa interes;

(ii) Deklaratë e thjeshtë shkresore e datës **.12.2011, e z. *** dhe subjektit të rivlerësimit, në të cilën deklarohet se, nisur nga fakti se subjekti është në pamundësi për të kthyer huan e marrë, deri në atë moment në vlerën 107.500 euro, sipas kontratës së huas datë **.1.2011, përdorur për porositjen e apartamentit nga shoqëria “****” sh.p.k., palët bien dakord që z. *** të bëhet titullar i të gjitha të drejtave mbi apartamentin e porositur nga subjekti i rivlerësimit. Palët angazhohen të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme juridike kundrejt “*” sh.p.k., për zgjidhjen e kontratës së porosisë datë **.1.2011, dhe kalimin e të gjitha të drejtave mbi apartamentin në emër të z. *** ***, duke u konsideruar e zgjidhur përfundimisht marrëdhënia e huas midis palëve;

(iii) Deklaratë noteriale nr. ***/***, datë **.12.2011, me deklarues shoqërinë “****” sh.p.k. dhe subjekti i rivlerësimit, nënshkruar edhe nga z. ***, ku deklarohet se palët zgjidhin kontratën e porosisë nr. ***/*** të datës **.1.2011, dhe për këtë apartament shoqëria “****” sh.p.k. do të lidhë kontratë paraprake me z. ***, për të njëjtin çmim shitje. Në këtë deklaratë saktësohet “... se subjekti i rivlerësimit ka paguar jashtë zyrës noteriale shumën 107.500 euro... Pagesa e bërë nga z. Hoxhaj i kalon në favor të z. *** **”,

(iv) Kontratë noteriale paraprake shitje nr. ***/***¹⁴ datë **.12.2011, nënshkruar ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe z. *** *** në cilësinë e palës blerëse, për pasurinë apartament ndodhur në katin e dytë të banimit, ap. me nr. *, me sip. 166,92 m². Në këtë kontratë është shtuar dhe blerja e dy garazheve në çmim total 44.000 euro, vlerë e cila duhet të paguhej brenda muajit qershor 2012;

¹³ Sipas kontratës, modalitetet e pagesës janë: (i) Kësti i parë prej 112.671 euro, paguhet me nënshkrimin e kontratës nga palët. Porositësi brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate duhet ta bëjë derdhjen e kësaj shume në ***...Një pjesë e kështit të parë në shumën 75.000 euro iu paguan *cash* në dorë në momentin e nënshkrimit të kontratës ndërsa pjesa tjetër e kështit të parë prej 37.671 euro do të paguhet siç është shprehur më lart; (ii) Kësti i dytë në shumën 90.136 euro do të paguhet brenda muajit qershor 2011. Në rast se nuk paguhet brenda këtij afati dhe kalojnë 30 ditë nga dita e fundit e muajit qershor, porositësi pranon se është tërhequr nga blerja e apartamentit dhe respektohet neni 7 I kësaj kontrate; (iii) 10% në vlerë 22.534 euro do të paguhet me përfundimin e objektit dhe me marrjen në dorëzim të apartamentit nga porositësi.

¹⁴ Modalitetet e pagesës në kontratë janë përcaktuar: (i) pagesa e shumës 107.500 euro është paguar jashtë zyrës noteriale nga z. Besnik Hoxhaj dhe kalon në favor të *** *** (sipas deklaratës noteriale nr. ***/***, datë **.12.2011); (ii) pagesa e shumës 50.000 euro do të bëhet brenda datës **.1.2012; (iii) pagesa e shumës 45.308 euro do të paguhet brenda datës **.5.2012; (iv) pagesa e shumës prej 22.535 euro do të paguhet në momentin e përfundimit të objektit.

(v) Kontratë kredie bankare datë **.3.2012, lidhur ndërmjet ***-së dhe z. *** ***, për një kredi në shumën 19.100.000 lekë, me qëllim blerjen e një apartamenti nga “****” sh.p.k., në rrugën “**** ****”. Në këtë kontratë kredie, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Hoxha, ka nënshkruar në cilësinë e garantuesit të kredimarrësit/debitorit.

(vi) Deklaratë noteriale nr. ***/***, datë **.5.2012, me deklarues shoqëria “****” sh.p.k. dhe z. *** ***, në të cilën deklarohet kalimi i shumës prej 18.000.000 lekë në llogarinë e “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit. Shuma 6.952.500 lekë do të qëndrojë në llogarinë bankare të kompanisë për pagesën e kështit. Pjesa e mbetur prej 11.047.500 lekësh, do të tërhiqet nga përfaqësuesi i kompanisë z. *** ***, dhe do t'i kthehet z. *** ***. Ky i fundit deklaroi se e ka marrë këtë shumë;

(vii) Deklarata noteriale e datës **.1.2016, nënshkruar nga deklaruesit, shoqëria “****” sh.p.k., dhe z. *** ***, në të cilën deklarohet se në muajin maj të vitit 2013, kanë revokuar kontratën e shitjes paraprake dhe se të gjitha pagesat i janë kthyer z. ***.

2.12 Komisioni, në vlerësim të fakteve të përshkruara si më sipër, në funksion të verifikimit të rrethanave që mund të ngrenë dyshime për fshehje, mosdeklarim apo paraqitje/deklarim në mënyrë të pasaktë të pasurive, ka gjykuar të nevojshëm hetimin mbi burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie dhe bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi: (i) *Duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë dhe vijon të jetë i vetmi përdorues/posedues, në mënyrë të pandërprerë, i pasurisë në analizë, ndonëse ndër vite janë ndryshuar porositësit dhe pronarët e apartamentit në fjalë. Në këto kushte Komisioni ngre dyshime se kjo mund të jetë një pasuri e krijuar me mjete financiare të subjektit të rivlerësimit, për llogari të tij dhe e pa deklaruar, me qëllim shmangien e verifikimit të burimeve të përdorura për krijimin e saj;* (ii) *Duket se huadhënësi z. *** ka patur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej – 9.524.478 lekë, për dhënien e huas prej 107.500 Euro, subjektit. Për rrjedhojë, duket se subjekti i rivlerësimit, në momentin e kryerjes së pagesës së kështit të parë të apartamentit në analizë, ka patur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej – 9.524.478 lekë;* (iii) *Duket se ka patur një deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, përgjatë procesit të rivlerësimit, sa i përket vendbanimit të familjes së tij, përgjatë periudhës 2010 – 2015.*

2.13 Komisioni, pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim lidhur me këtë pasuri, në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar se:

2.13.1 *Lidhur me përdorimin e apartamentit në rr. “**** ****”, në pronësi të znj. *** ***, përdorur nga subjekti sipas marrëveshjes së datës **.8.2010, nuk mund të ngrihen dyshime për pasuri të fshehur të subjektit, për sa kohë ai është blerë nga znj. ***. ***, me burime të ligjshme, shumë vite përpara se të përdorej nga subjekti dhe kjo marrëdhënie është formalizuar në kohë reale dhe më pas është paraqitur pranë organeve verifikuese¹⁵.*

2.13.2 *Lidhur me përdorimin e apartamentit në rr. “**** ****”, Komisioni, ka vlerësuar se pamjaftueshmëria e burimeve të z. *** është në shumën – 1.507.535 lekë, në rast të konsiderimit në mesin e burimeve të ligjshme të shumës prej 25.000 euro pjesë të kredisë marrë nga *** Bank, apo – 4.977.603 lekë, në rast moskonsiderimi të kësaj shume¹⁶, duke konkluduar se: [...] këto*

¹⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 31-32, të vendimit.

¹⁶ Bazuar në Rekomandimin për paraqitje ankimi nga vëzhguesit ndërkombëtare, aktit me nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, në mesin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur huadhënësit z. *** ***, në rast të moskonsiderimit të të ardhurave nga kontratat e qirave të paraqitura vetëm në rezultatet e hetimit administrativ si dhe gjithë shumës së pretenduar prej 50.000 euro me burim kredinë pranë *** Bank, në vitin 2010, diferenca negative do të thellohej në masën rreth - 12.437.441 lekë, pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë.

pamundësi financiare të huadhënësit, përpos masës së tyre, nuk mund të sjellin pasoja për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë ato janë përdorur përkohësisht, duke u kthyer pas tek huadhënësi, pas pak javësh – nëpërmjet zëvendësimit të pozicionit të porositesit. Kjo dinamikë faktesh çon në konkluzionin se marrëdhënia e huas në fjalë nuk ka gjeneruar/krijuar asnjë përfitim pasuror apo financiar në sferën e interesave të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë porosia e tij është prishur pak më vonë, pa prodhuar asnjë efekt juridiko-financiar [...]

2.13.3 Në përfundim për pasurinë apartament me adresë në rr. “**** ****”, Komisioni ka konkluduar: [...] *nisur nga vlerësimi faktiko-ligjor se nuk ka të bëjë me një pasuri të fshehur, rrjedhimisht, trupi gjykues vlerëson se përpos mospërputhjeve të disa deklarimeve apo përgjigjeve të subjektit apo të përfaqësuesve të tij ligjorë, me fakte apo sqarime të tjera, nuk gjendet as përballë elementeve të mjaftueshme që do të përbënin shkak për cenimin e besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit në sistemin e drejtësisë, pasi mospërputhjet, konfuzioni, paplotësia apo lapsuset e mundshme përgjatë procesit të rivlerësimit, për sa kohë kanë gjetur një qartësim apo kristalizim final, në prag të konkludimit të këtij rivlerësimi, porë në frymën e proporcionalitetit, nuk mund të përbëjnë në vetvete shkak të mjaftueshëm për të aplikuar masën e shkarkimit për një subjekt¹⁷ [...]*

2.14 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, si lidhur me vlerësimin e situatës faktike për fshehjen e pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016, ashtu dhe sa i përket vlerësimit të situatës financiare, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimeve të huas së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, shumës 107.500 euro, që ka shërbyer për pagesën fillestare të pasurisë apartament banimi në posedim dhe gëzim të pandërrerë të subjektit, duke analizuar si më poshtë:

2.14.1 Nga vlerësimi tërësor i akteve të administruara, duket se qëllimi i subjektit të rivlerësimit ka qenë që të investojë dhe të jetojë në apartamentin e ndodhur në rr. “**** ****”, që prej vitit 2011, duke porositur këtë pasuri menjëherë pas transferimit të tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vitin 2010. Edhe pse apartamenti në fjalë ka qenë objekt i disa transaksioneve nga blerës të ndryshëm (subjekti i rivlerësimit, z. *** ***, znj. *** ***, shoqëria “****” sh.p.k.), rezulton të jetë përdorur dhe gëzuar vetëm nga subjekti i rivlerësimit.

2.14.2 Duket se subjekti i rivlerësimit përpiket ta paraqesë situatën faktike ndryshe nga sa kanë rrjedhur ngjarjet dhe interesat e tij pasurore me këtë pasuri, si dhe momentit të posedimit të saj. Për sa i përket dy marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me znj. ***, të cilat duket se i përkasin dy pasurive të ndryshme, në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, subjekti fillimisht ka pretenduar se bëhej fjalë për të njëjtin apartament (atë në rr. “**** ****”), të cilin nuk mund ta përdorte pasi në atë kohë ishte i pabanueshëm dhe i pa përfunduar, duke pretenduar se vetëm me marrëveshjen e dytë të lidhur me znj. ***, është zhvendosur me banim së bashku me familjen në Tiranë.

2.14.3 Mbi pasurinë e poseduar nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, rezulton të kenë ndodhur një sërë situatash dhe veprimesh juridike, që përpos faktit që kanë krijuar mbivendosje, janë dhe të pa logjikshme në kuptimin e një qarkullimi normal dhe të lirë civil të sendit, shtuar këtu subjektet/personat që marrin pjesë, të cilët në mënyrë të vazhdueshme ndërthuren me interesat private të subjektit të rivlerësimit. Nisur nga këto rrethana, pavarësisht marrëveshjeve dhe kontratave të listuara më sipër, duket se qëllimi i subjektit të rivlerësimit për posedimin dhe gëzimin

¹⁷ Referohuni arsytimit të Komisionit në f. 32-36, të vendimit.

e kësaj pasurie është konsistent, realizuar fillimisht me kontratën e porosisë në janar në vitin 2011, e më pas nëpërmjet personave të tretë, të njohur të subjektit të rivlerësimit me ndërthurje interesash private. Sikundër ka rezultuar, huadhënësi i subjektit të rivlerësimit, z. *** shfaqet fillimisht si palë për blerjen e banesës në dhjetor 2011, ndërsa pesë vite më pas me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.1.2016 ka pretenduar zgjidhjen e kontratës paraprake të shitjes që në maj të vitit 2013. E njëjta pasuri, blihet nga znj. *** dhe menjëherë kjo pasuri, referuar marrëveshjes së depozituar nga subjekti, i jepet në përdorim këtij të fundit. Në vijim, kjo pasuri shitet nga znj. ***, në emër të së cilës vepron me prokurë vëllai i z. ***, duke ia kaluar pronarit të ri, shoqërisë “****” sh.p.k., e cila, lidh kontratë qiraje në vitin 2018 me subjektin e rivlerësimit, me një çmim të papërfillshëm (25.000 lekë), nisur nga çmimet e qirave në tregun e lirë të banesave, referuar zonës dhe hapësirës banuese (ap. 3+1).

2.14.4 Ndërthurja e interesave private të subjektit të rivlerësimit dhe personave të njohur prej tij, të cilët shfaqen gjithnjë në transaksionet juridike, dalin në pah nga një sërë faktesh të tjera, si, apartamenti porositet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kontratës noteriale në **.1.2011, duke paguar detyrimet përkatëse nëpërmjet një huaje (formë shkresore, paraqitur vetëm gjatë hetimit administrativ) të marrë nga z. *** në **.1.2011. Kjo hua duket se është anuluar brenda të njëjtit vit, duke transferuar gjithë të drejtat e subjektit mbi këtë pasuri tek huadhënësi i tij, z. ***, në dhjetor 2011. Më tej, rezulton se subjekti i rivlerësimit edhe pse kalon të gjithë të drejtat dhe detyrimet e tij të porosisë mbi këtë pasuri, duke shfaqur në dukje ndërprerjen e çdo interesi dhe marrëdhënie juridike me të, pak kohë më pas, në vitin 2012, del si garantor i kredisë së marrë nga z. *** pranë ***-së, për shumën 19.100.000 lekë, pikërisht me qëllim blerjen nga ky i fundit të të njëjtit apartament.

2.14.5 Megjithëse blerësi potencial, z. ***, ka shlyer një pjesë të çmimit të pasurisë, duke marrë dhe kredi për këtë qëllim, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një deklaratë noteriale të janarit 2016, me deklaruës shoqërinë “****” sh.p.k., dhe z. Ç. ***, në të cilën deklarohet, ndër të tjera, se palët kanë anuluar veprimet mes tyre, duke vendosur kthimin mbrapsht të të gjithave pagesave tek z. ***. Edhe pse në këtë deklaratë të vitit 2016, referohet se anulimi është bërë që në muajin maj të vitit 2013, në dosje nuk rezulton ndonjë provë që të provojë këtë fakt të deklaruar. Më pak se një muaj më vonë nga deklarata noteriale e ** janarit 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur marrëveshjen e dytë të shkëmbimit me znj. ***. ***, e cila kishte blerë apartamentin me kontratën noteriale të ** janarit 2016, me shitëse ***. ***. Mbetet i paqartë interesi i znj. *** për të blerë këtë apartament në Tiranë, të cilin ajo nuk e ka shfrytëzuar, por menjëherë ia ka dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit.

2.14.6 Pasuria në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, me kontratën noteriale të dhjetorit 2017 shitet nga ana e znj. ***, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi *** ***, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. Lidhur me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, se ndoshta znj. *** ka ardhur në dijeni të anulimit të marrëveshjes nga z. *** *** me shoqërinë “****” sh.p.k., pikërisht nëpërmjet vëllait të tij, z. *** ***, dhe për këtë arsye ka hyrë në marrëveshje për blerjen e pasurisë.

2.14.7 Lidhur me marrëdhëniet me znj. *** dhe konfliktin e mundshëm të interesit, subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë lidhje me të dhe e njeh vetëm nga shkëmbimi i apartamenteve, ndërkohë që nga hetimi administrativ ka rezultuar një vendim i subjektit të rivlerësimit në mars të vitit 2010¹⁸.

¹⁸ Me objekt njohjen dhe caktimin e trashëgimtarëve të ish bashkëshortit të znj. ***, trajtuar në vijim në kriterin e aftësive profesionale.

2.14.8 Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për deklarimin e përdorimit të pasurisë në deklaratat periodike vjetore, *Komisioneri Publik* vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron dhe është i pabazuar në ligj, pasi formulari i deklarimit periodik vjetor, përveçse adresës së regjistruar në gjendjen civile, në një seksion të posaçëm, kërkon dhe deklarimin nëse subjekti deklarues posedon adresë tjetër banimi, sikundër deklaruar nga subjekti në DV-2016. Subjekti nuk ka deklaruar vendqëndrimin e tij dhe familjarëve në këtë adresë as gjatë hetimit administrativ, edhe pse nga aktet në dosje ka rezultuar se fëmijët e subjektit ndiqnin arsimin privat në qytetin e Tiranës të paktën që prej vitit 2010, ndërsa bashkëshortja e tij ka rezultuar e punësuar në Tiranë, që prej vitit 2011, por vazhdimisht ka pretenduar se jetonin në Shkodër dhe udhëtonin drejt Tiranës me makina të rastit.

2.14.9 Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar as marrëdhënien me shtetasin z. *** në vitin 2011 dhe huan në vlerën 107.500 euro apo dhe cilësinë e tij si dorëzanës për kredinë e marrë nga ky shtetas pranë ***-së në vitin 2012, në shumën 19.000.000 lekë. Kjo kredi, sikurse u përmend edhe më sipër, ka shërbyer për shlyerjen e detyrimit të mbetur për blerjen e apartamentit në posedim nga subjekti i rivlerësimit.

2.14.10 Në analizën e situatës faktike si më sipër, merr rëndësi dhe vlerësimi i mundësisë financiare të huadhënësit, z. *** për të dhënë hua shumën prej 107.500 euro në janar 2011 subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës, pasi edhe në konsideratë të rishikimit të të ardhurave të z. ***, sipas akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, për të cilat vlen të theksohen se janë sjellë në një fazë të avancuar të hetimit, megjithëse janë kërkuar që në pyetësin nr. 3, nga analiza financiare do rezultonte sërish pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të huadhënësit për të dhënë huan e deklaruar.

2.14.11 Pretendimi i subjektit mbi përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të huadhënësit të kredisë të marrë nga ky i fundit pranë *** Bank, datë **.10.2010, në shumën 50.000 euro, duket se është një transaksion që nuk ka logjikë ekonomike. I pa provuar mbetet dhe pretendimi i subjektit lidhur me shumën 25.000 euro dhe kthimi mbrapsht në *cash* i kësaj shume, nga shtetasi *** te ***. Kjo shumë rezulton e transferuar në llogarinë bankare të z. ***, në datën **.11.2010, me përshkrimin “*kalim nga *** për likuidim punimesh*”, veprim i cili duket në linjë logjike me qëllimin e marrjes së kredisë, sipas përcaktimit në kontratë “*Investime (Godinë Banimi)*”. Deklaratat noteriale¹⁹ të depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerësohet se nuk provojnë pretendimet e subjektit, në mungesë edhe të ndonjë akti tjetër të kohës.

2.14.12 Në të gjitha variantet e kryerjes së analizës mbi mundësinë financiare të huadhënësit z. ***, rezulton se ky i fundit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 107.500 euro. Referuar rekomandimit të ONM-së, mungesa e burimeve të ligjshme të huadhënësit, z. *** do të çonte në pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për pagesën e këstit të parë të apartamentit në janar të vitit 2011, në vlerën 107.500 euro, si dhe pamjaftueshmëri financiare për vitin 2011, në shumën - 15.269.758 lekë.

2.15 Duke përfunduar, nisur nga: (i) deklaratimet kontradiktore dhe jo të vërteta të subjektit të rivlerësimit, mbi kohën, adresat e banimit dhe vendqëndrimin për periudhën që nga viti 2010 e vijim; (ii) transaksionet e vazhdueshme ku shfaqet subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë me ndërthurje të interesave private mes tyre; (iii) posedimi dhe gëzimi në mënyrë të pandërprerë i së

¹⁹ Përkatesisht deklaratat noteriale e z. *** me nr. ***/***, datë **.4.2023 dhe ajo e z. ***, ***, me nr. ***/***, datë **.4.2023.

njëjtës pasuri nga ana e subjektit të rivlerësimit, objekt i këtyre transaksioneve; si dhe (iv) pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të huadhënësit z. *** për të dhënë huan në vlerën 107.500 euro në vitin 2011 subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/2 prot., datë 19.6.2023, janë fakte të cilat të vlerësuara në tërësi, çojnë në përfundimin se, më së paku, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në fjalë dhe interesat e vërteta pasurore të tij, rrethana këto që çojnë në aplikimin e nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, situatë e cila duhet të vlerësohet edhe në vështrim të nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5 e këtij ligji.

3. *Për shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimin, nga hetimi administrativ ka rezultuar se:*

3.1 Komisioni, ka kryer analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën e deklaramit 2003-2016, analizë nga e cila ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet, investimet dhe kursimet ndër vite, për një diferencë negative prej - 6.293.084 lekë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën.

3.2 Subjekti i rivlerësimit, përveç sa ka prapësuar lidhur me kostot e ndërtimit të pasurisë godinë banimi në Shkodër dhe shpenzimeve të jetesës për periudhën deri në vitin 2000, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ ka kundërshtuar dhe përlllogaritjet e shpenzimeve të udhëtimit për të dhe personat e lidhur me të, duke vënë në dispozicion dhe disa deklarata të shtetasve të ndryshëm, të cilët konfirmojnë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit të subjektit për periudhën e deklaramit.

3.3 Komisioni, në përfundim, pasi ka analizuar dhe shqyrtuar prapësimet e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur prej tij, ka rishikuar analizën financiare duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit²⁰ dhe reduktuar ndjeshëm kështu²¹ pamjaftueshmërinë financiare për periudhën 2003 – 2016²².

3.4 *Komisioneri Publik*, në vlerësim të akteve të administruara, bazuar dhe në rekomandimin e ONM-së, ndan gjykim të ndryshëm lidhur me metodologjinë e analizës përfundimtare të kryer nga ana e Komisionit dhe rishikimit të kostove të shpenzimeve të udhëtimit.

3.4.1 Subjekti i rivlerësimit i pyetur mbi shpenzimet e udhëtimit dhe kostot e tyre, në pyetësorin standard, datë 5.2.2021, ka deklaruar se: *“... kam udhëtuar ndër vite jashtë vendit për arsye të ndryshme kryesisht udhëtime familjare dhe së fundmi në qytetin e Londrës për të vizituar djalin tim. Të gjitha udhëtimet e mia kanë qenë të shoqëruar nga familjarët e mi znj. *** ***, bashkëshortja dhe 2 fëmijët e mi”*, duke mos saktësuar asnjë të dhënë mbi udhëtimet e evidentuara nga Komisioni gjatë periudhës objekt kontrolli, apo mbulimit të kostove të tyre nga persona të afërm. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 lidhur me kostot e udhëtimeve, subjekti ka deklaruar: *“Do të plotësojmë sa mundemi... Jam në pamundësi objektive për të plotësuar këto të dhëna për shkak të kohës së kaluar dhe mosruajtjes së dokumentacionit”*.

3.4.2 Vetëm pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklarata personale të të afërmeve apo miqve të tij, ku deklarohet mbulimi prej tyre i shpenzimeve të

²⁰ Janë përjashtuar nga kjo përlllogaritje shpenzimet e kryera nga subjekti në lidhje me udhëtimet e kryera prej tij dhe personat të lidhur me të, me destinacion Hungarinë, Austrinë dhe Slloveninë, për të cilat trupi gjykues i vlerësoi jo të mjaftueshëm dokumentacionin e paraqitur nga subjekti.

²¹ Duke konsideruar edhe vlerësimet dhe përfundimet për ndërtimin e banesës në Shkodër sikundër trajtuar më sipër.

²² Për më tepër referohuni në f. 43-44, të vendimit.

udhëtimit dhe akomodimit për subjektin e rivlerësimit dhe familjarët e tij. Në një pjesë të deklaratave të vëna në dispozicion nuk specifikohen as datat e udhëtimeve apo të dhëna të tjera ndihmëse. Mbulimi i këtyre shpenzimeve, duke u konsideruar dhuratë apo edhe trajtim preferencial, nuk rezulton të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit as në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, edhe pse rezultojnë në vlera të konsiderueshme²³. Duket se qëllimi i hartimit dhe paraqitjes së këtyre deklaratave vetëm pas kalimit barrës së provës, është për lehtësimin e pozitës financiare, të konstatuar negative për subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu nuk rezulton që për të gjithë deklaruesit, të jenë paraqitur nga subjekti akte të rezidencës së tyre në momentin e mbulimit të kostove të akomodim/udhëtimit, apo akte mbi mundësitë financiare të tyre për të pritur dhe mbuluar kostot për familjen e subjektit të rivlerësimit.

3.4.3 *Komisioneri Publik*, bazuar në sa më sipër, vlerëson se deklaratat e depozituara nga subjekti mbi mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe udhëtimit, depozituar vetëm pas kalimit të barrës së provës, duhet të vlerësohen si përpjekje e tij për të pasqyruar në mënyrë jo të vërtetë dhe me qëllim justifikimin e pamjaftueshmërisë së konstatuar, e si të tilla, ato nuk duhet të merren në konsideratë dhe shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten mbështetur në metodologjinë e përcaktuar nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 11/2019. Përrjashtim nga rasti në fjalë mund të bëjnë vetëm kostot e qëndrimit për udhëtimet e subjektit dhe familjarëve në shtetin Turk, për rastet kur udhëtimet janë bërë me linja ajrore të ndryshme nga *Charter*, sikundër konstatohet në disa raste, për shkak të lidhjes së afërt familjare të subjektit me shtetasin ***. *** (i vëllai), lidhje e provuar dhe deklaruar dhe në faza më të hershme të hetimit administrativ. Bazuar në këtë arsyetim, reduktimi i shpenzimeve të kostove të qëndrimit, do të ishte i papërfillshëm në rezultatin financiar të periudhës së deklarimit.

3.5 Duke përfunduar, lidhur me shpenzimet e udhëtimit, Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

4. *Përdorimi i automjeteve në pronësi të të tretëve*

4.1 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë përdorur automjete të ndryshme në pronësi të të tretëve. Këto të dhëna kanë shërbyer për Komisionin si për kontrollin e kriterit të pasurisë, ashtu edhe për kontrollin e kriterit të aftësive profesionale, lidhur me konfliktin e interesit dhe etikën e magjistratit. Konkretisht, nga të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit²⁴, si dhe nga verifikimi i kryer nga Komisioni *online*, në sistemin informatik të AMF-së, ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur (familja e tij), kanë qenë përdorues të tre automjeteve: (i) tip “Porsche”, me targë ***...***; (ii) tip “Jaguar”, me targë ***...***, në pronësi të shtetasit ***.***, e në përdorim nga subjekti, bashkëshortja dhe djali i tij, gjatë periudhës 2013 – 2015; (iii) tip “Mercedes-Benz”, me targë ***...***, në pronësi të shtetasit ***.***, në përdorim nga subjekti gjatë periudhës 2014 – 2018²⁵.

²³ Sipas analizës financiare të vënë në dispozicion të subjektit nga Komisioni, shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për periudhën e deklarimit 2003-2016 llogariten në vlerën rreth 8.4 milionë lekë.

²⁴ Referuar shkresës nr. ***/* prot., datë **/8.2020.

²⁵ Lidhur me përdorimin e automjetit tip “Jaguar” dhe “Mercedes-Benz”, trajtimi i Komisionit ka gjendur vend në vlerësimin e kriterit të pasurisë, ndërsa lidhur me të dhënat e dala nga kontrolli i këtij kriteri (si rasti i familjes ***, znj. ***, z. *** dhe z. ***) kanë gjetur trajtim në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trajtuar më gjerësisht në shkaqet e ankimit mbi kriterin e aftësive profesionale.

4.2 Referuar arsyetimit të Komisionit²⁶ subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve nr. 4 dhe 5, ka deklaruar, ndër të tjera, se me pronarët e mjeteve të përdorura prej tij ka marrëdhënie shoqërore dhe familjare, pa konflikt interesi, duke sqaruar se automjeti në pronësi të shtetasit ***.***., tip “Jaguar”, është përdorur prej tij jo më shumë se 2-3 herë. Ndërsa në lidhje me automjetin tip “Cadillac”, me targë ***...***, në përgjigje të pyetësorëve nr. 3 dhe 4, subjekti ka deklaruar se ky automjet ka qenë në pronësi të shtetasve *** dhe ***. ***.. Ndërkohë, Komisionit nga verifikimi në sistemin *online* të AMF-së, i ka rezultuar se në vitin 2007, kur subjekti ka udhëtuar me këtë automjet, ai, ka qenë në pronësi të z. ***. ***.²⁷ Në vijim, Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër²⁸, vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në të cilat shtetasi ***.***. ka rezultuar palë, vendimet nr. ***/2001 dhe nr. ***/2001. Komisioni ka vlerësuar se çështjet me z. ***.***., i përkasin vitit 2001, ndërkohë përdorimi i automjetit ka ndodhur rreth 6 vite më pas.

4.3 Lidhur me përdorimin e *automjetit “Mercedes-Benz”*, me targë ***...***, në pronësi të shtetasit ***.***., për të cilin kanë rezultuar polica sigurimi në emër të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 2014-2018, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka vlerësuar se ai ka pasur detyrim ligjor për ta deklaruar këtë marrëdhënie në D. -Vett.

4.3.1 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka prapësuar se automjeti në pronësi të shtetasit ***.***., është përdorur për të udhëtuar vetëm një herë jashtë vendit, duke pranuar se, ndonëse ky automjet është përdorur disa herë prej tij, nuk ka qenë ndonjëherë në përdorimin e tij të mirëfilltë për ta shfrytëzuar në përditshmërinë e tij. Sipas subjektit, përdorimi në një rast sporadik i këtij automjeti, nuk i përkon ndonjë rubrike deklarimi në D. - Vett. apo atyre periodike vjetore.

4.4 Komisioni, për sa më sipër, ka vlerësuar se: [...] *duke marrë në konsideratë faktin se përdorimi i këtij automjeti nga subjekti është i provuar për vetëm një udhëtim, ndonëse nga polica e sigurimit përkatëse i njuh subjektit të rivlerësimit tagrin e përdorimit të këtij automjeti, për një hark kohor rreth 2 vite (për periudhën 2016 – 2018²⁹), ky fakt nuk e provon përdorimin real të automjetit, por mundësinë teorike për përdorimin e tij. ... Komisioni, edhe pse nuk mund të përjashtohet mundësia e përdorimeve të tjera të mundshme (në mungesë të një prove konkrete në këtë drejtim), nuk e konsideron penalizues për subjektin rastin specifik në kontekstin dhe rrethanën de qua. Ky vlerësim bazohet veçse në jurisprudencën e deritanishme, për sa kohë gjendet përballë një përdorimi sporadik/unik edhe në rrethanat e mbi të dhënat konkrete të disponuara, nga të cilat çmohet se nuk plotësohen kriteret faktiko-ligjore, për t’u konsideruar subjekti i rivlerësimit në cilësinë e përdoruesit të automjetit, nga ku mund të lindte edhe detyrimi për deklarimin e kësaj marrëdhënieje [...]*³⁰.

4.5 *Komisioneri Publik*, në vlerësim të akteve të administruara, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson se përfundimi i Komisionit nuk është i drejtë dhe rezulton i pambështetur në prova. Polica e sigurimit, e lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2014-2018, është një provë e cila tregon se përdorimi i automjetit nga ana e subjektit të rivlerësimit ka ndodhur përgjatë këtyre viteve, referuar dhe kohëzgjatjes së policave të sigurimit. Në këtë kontekst, referimi i Komisionit në vendimin (JR) nr. 42/2022, nuk mbështetet në situatën faktike të rastit në shqyrtim dhe nuk mund të merret në konsideratë.

²⁶ Referohuni f. 37-38, të vendimit të Komisionit.

²⁷ Për më tepër referohuni në pikën 148, f. 38, e vendimit të Komisionit.

²⁸ Referuar shkresës me nr. ***/* prot., datë *.2.2023.

²⁹ Në vendimin e arsyetuar, Komisioni referon se polica e sigurimit është 2014-2018, pika 151, f. 39 e vendimit.

³⁰ Për më tepër referohuni në f. 39 - 40, të vendimit të Komisionit.

4.5.1 Në arsyetimin e tij, Komisioni ka pranuar versionin dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë deklarative dhe nuk kundërshtojnë për sa është konstatuar nga policat e sigurimit, si dhe nuk i përgjigjen faktit se përdorimi i mjetit nuk është deklaruar asnjëherë. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, sikurse parashtrohet edhe në Rekomandim e ONM-së, praktika gjyqësore që gjen zbatim për rastin është vendimi (JR) nr.12/2021, i Kolegjit, ku ndër të tjera, është arsyetuar se: [...] 27.10 Kolegji vlerëson ...neni 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij automjeti si një pasuri në përdorim të tij – sjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për ta deklaruar si pasuri në përdorim përderisa nga policat e sigurimit sipas sistemit të AMF-së, ai rezultonte se kishte të drejta përdorimi mbi këtë automjet për periudhën e sigurimit **7.2016 – **7.2017, periudhë e cila përfshin brenda saj kohën e depozitimit të deklaratës së pasurisë Vetting në datën **01.2017 [...].

4.6 Duke përfunduar, Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, nisur nga vlerësimi i mësipërm i arritur nga Kolegji, në kontekstin e rrethanave të rezultuara nga aktet e administruara, të cilat tregojnë se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, si para momentit të dorëzimit të Deklaratës Vetting dhe më pas, çmon se mosdeklarimi i kësaj të drejte reale, çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

II. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale. Konflikti i interesit

5. Nga hetimi administrativ i Komisionit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, parë në raport me ushtrimin e funksionit të tij dhe etikës së magjistratit, bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit kushtetues, kreu VI të ligjit nr. 84/2016 dhe, për aq sa gjen zbatim ligji nr. 96/2016, kanë rezultuar si gjetje : (i) subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të funksionit, mund të ketë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar çështje me palë procedurale me të cilat ka pasur marrëdhënie kontraktuale, shit-blerje të pasurive të paluajtshme; si dhe (ii) subjekti i rivlerësimit mund të ketë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, apo atij në dukje, pasi ka gjykuar çështje me palë procedurale, me të cilat, subjekti ka udhëtuar në të njëjtin mjet.

6. Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrë prove për rastet e çështjeve të gjykuara prej tij, për rastet si në vijim:

7. **Rasti i familjes “***”**. Nga aktet e administruara, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, me vendimin nr. ***, datë **.6.2003, ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit *** ***, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë bashkëshorten e tij *** ***, dhe fëmijët ***, ***, e ***, ***, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën **.7.2003.

7.1 Ndërkohë, sikundër trajtuar edhe më sipër në kriterin e pasurisë, ka rezultuar se vetëm 1 muaj e gjysmë më pas, në datën **.8.2003, subjekti i rivlerësimit me kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., ka blerë një pjesë të pasurisë trashëgimore, shtëpi banimi ndodhur në lagjen “***”, Shkodër, në pronësi të familjes Dreni, për shumën 900.000 lekë.

7.2 I pyetur lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit me pronarët e kësaj pasurie, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë lloj marrëdhënie me ta. Ndërsa në lidhje me çështjen gjyqësore, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se më këta shtetas ka thjeshtë një marrëdhënie indiferente dhe, referuar përgjigjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. ***/* prot., datë **.3.2022 dhe shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***/* prot., datë **.3.2022, nuk ka gjykuar asnjë çështje lidhur me ta, duke mos qenë në kushtet e konfliktit të interesit.

7.3 Komisioni i ka kaluar barrën e provës pasi duket se krijimi i kësaj marrëdhënie interesi me përfituesit e trashëgimisë, familje “****”³¹ rreth një muaj pas vendimit të marrë nga subjekti, në procesin gjyqësor, pikërisht për çeljen e trashëgimisë në fjalë, ngre dyshime për cenimin e etikës së gjyqtarit.

7.4 Pas prapësimeve të subjektit, Komisioni ka vlerësuar se periudha e gjykimit të çështjes është jashtë harkut kohor të përcaktuar nga neni 41 i ligjit nr. 84/2016.

8. Rasti i znj. *. ***.** Nga kontrolli i kriterit të pasurisë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhur dy marrëveshje me znj. ***³² (shkëmbim qiraje), respektivisht në datë **.8.2010, si dhe në datë **.2.2016³³.

8.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.12.2021, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. *** datë **.3.2010, ka vendosur “*Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin *** ****”, duke njohur si trashëgimtarë ligjorë me ¼ pjesë secili të pasurisë trashëgimore, bashkëshorten znj. *** *** dhe fëmijët e tyre ***, ***, dhe ***. ***. Ndërkohë subjekti kishte nënshkruar një marrëveshje me shtetasen ***. ***, rreth 5 muaj para se të shqyrtonte çështjen gjyqësore për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, me kërkuese këtë të fundit.

8.2 I pyetur në lidhje me marrëdhëniet shoqërore/familjare me këtë shtetase, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 5, ka deklaruar se ka pasur një njohje të paktë, pa frekuentime apo takime dhe se nuk e mbante mend kohën kur e kishte njohur. Pas kalimit të barrës së provës, referuar parashtresës së datës 16.5.2023, subjekti ka prapësuar se vendimmarrja e tij për lëshimin e trashëgimisë ligjore është e natyrës deklarative dhe, si e tillë, nuk ka si të ketë ndikuar në veprimet juridike të mëpasshme.

9. Rasti i z. *. ***.** Nga kontrolli i kriterit të pasurisë, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur marrëdhënie financiare dhe interesa të përbashkëta me shtetasin ***. ***, si dhe janë konstatuar disa udhëtime të kryera jashtë vendit të kryera së bashku³⁴. Siç kemi trajtuar edhe për kriterin e pasurisë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë hua nga z. ***. *** shumën 107.500 euro në vitin 2011, për blerjen e apartamentit të përdorur prej tij në rr. “ *** *** ”, Tiranë.

9.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.3.2022, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. *** datë **.3.2008 ka vendosur

³¹ Për blerjen e banesës, objekt i trashëgimisë të shqyrtuar nga subjekti.

³² Është vërtetuar me nënshkrimin e noterit nr. ** rep., datë **.10.2011, ku janë dakordësuar që të marrin me qira pronat e njëri-tjetrit pa pagesë, për 5 vjet. Banesa në pronësi të znj. *** *** është me sipërfaqe të ndryshme dhe nr. pasurie të ndryshëm (nr. ***/* me sip. 135 m², rr. “**** *** ”), nga ajo e përmendur në marrëveshjen e dytë.

³³ Marrëveshje me shkresë të thjeshtë (jonoteriale), sikundër trajtuar gjerësisht më sipër në pasurinë me adresë rr. “****. ***”.

³⁴ Gjatë hetimit administrativ i ka rezultuar se subjekti ka udhëtuar në shoqërinë e shtetasit ***. ***, në disa udhëtime si vijon: (i) në datën **.5.2007, shtetasi ***. *** ka qenë drejtues i mjetit me targë ***. ***, në pronësi të shtetasit ***. ***. (ii) Në datën **.8.2008, subjekti ka qenë drejtues i mjetit me targë ***. ***. (iii) Në datën **.3.2008, B. Hoxha ka qenë drejtues i mjetit me targë ***. ***. (iv) Në datën **.9.2011, ***. *** ka qenë drejtues i mjetit me targë ***. ***.

pranimin e padisë të palës paditëse ***.***, për “*Deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të aktit të lindjes, për sa i përket vendlindjes së fëmijës ***.***, i datëlindjes **5.2001*”.

9.2 Pas kalimit të barrës së provës, referuar parashtresës së tij, datë 16.5.2023, subjekti ka prapësuar që vendimmarrja e tij për *korrigjimin e akteve të gjendjes së lindjes*, është e natyrës deklarative dhe nuk ka ndikuar në veprimet juridike të mëpasshme.

10. Rasti i z. *.***.** Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë vendit me shtetasit ***.***., në një udhëtim 1-ditor, në datën **4.2010-**4.2010, i cili ka qenë drejtues i mjetit me targë ***...***, në pronësi të tij. Komisioni ka hetuar në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit³⁵ dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.12.2021, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar tri çështje me shtetasin ***.***, për të cilat ka dhënë vendimet si vijojnë:

(i) Me vendimin nr. ***, datë **.9.2009, subjekti ka vendosur *lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, të të ndjerit *** *** sipas kërkesës së palës kërkuese ***.***. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën **.10.2009.*

(ii) Me vendimin nr. ***, datë **.7.2009, subjekti ka gjykuar çështjen me palë kërkuese, ***.***., me objekt: “*1. Saktësimin dhe plotësimin e shënimeve në librin e pronësisë në vitin 1947, në lidhje me përcaktimin e kufitarëve, vendndodhjen e tokës arë me sip. 8 dynymë dhe kullotë 10 dynymë, në emrin e z. ***.***. 2. Vërtetimin e faktit juridik për sa i përket shënimeve të bëra në regjistrin e kadastrës së vitit 1947, me nr. **, se bëhet fjalë për të njëjtin person. 3. Rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur dokumentacionin pranë A. K. K. Pronave Qarku Shkodër*”. Person i tretë në gjykim, Komuna Rrethina Shkodër, ka qenë në mungesë. Në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesë padisë, duke marrë formë të prerë në datën **.8.2009.

(iii) Me vendimin nr. ***, të datës **.4.2010, subjekti ka gjykuar çështjen me palë kërkuese, ***.***, me objekt: “*Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore*”. Person i tretë në këtë gjykim ka qenë Zyra e Përmbarimit Shkodër, e cila ka qenë në mungesë. Në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës, pavlefshmërinë e veprimeve përmbarimore, për caktimin e ekspertit vlerësues të pasurisë, pavlefshmërinë e shpalljes për shitje në ankand të pasurisë së paluajtshme.

10.1 I pyetur lidhur me marrëdhënien familjare/shoqërore apo ekzistencën e konfliktit të mundshëm të interesit me shtetasin ***.***., subjekti, në pyetësonin nr. 3, nuk ka dhënë sqarime. Pasi është ripyetur nga Komisioni, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 5, ka shpjeguar se me këtë shtetas ka pasur një frekuentim shumë të rrallë. Kontaktet me të përfaqësoheshin nga 2 ose 3 herë në kafe me miq të përbashkët. Ai ka deklaruar se nuk i kujtohej momenti i njohjes me shtetasin në fjalë, për shkak të kontakteve shumë të rralla me të.

10.2 Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës pasi ngrihen dyshime se subjekti mund të ketë shqyrtuar dhe vendosur për çështjet e lartpërmendura, në kushtet e konfliktit të interesit dhe/ose duke shkelur etikën e magjistratit, për shkak të marrëdhënieve dhe udhëtimeve të kryera së bashku me palët në proces, përgjatë apo në afërsi të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore përkatëse, nga vet subjekti.

10.3 Në parashtresat e tij, datë 16.5.2023, subjekti ka prapësuar që me shtetasin ***.***., nuk kam njohje familjare apo shoqërore dhe vendimmarrjet e mia në lidhje me proceset gjyqësore janë

³⁵ SPAK, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.11.2021, ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara, mosfillim ose pushim të çështjeve penale në ngarkim të tyre.

pa asnjë ndikim dhe aq më pak të kem favorizuar këtë palë në proces. Lidhur me udhëtimin ka sqaruar se nuk e kujton këtë udhëtim, por kam pyetur për atë dhe më kanë thënë që punon si taksist.

11. Për të gjitha rastet e mësipërme, në përfundim, Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] Në vlerësim të rrethanave objektive, trupi gjykues ka konsideruar: (i) faktin e konstatuar gjatë hetimit se çështjet në fjalë (dy vendime për lëshimin e trashëgimisë dhe një vendim për korrigjimin e aktit të gjendjes civile sa i takonte vendlindjes së fëmijës) nuk kanë pasur për objekt apo të kenë zgjidhur një konflikt gjyqësor mes palëve, por kanë pasur natyrë deklarative; (ii) faktin e konstatuar gjatë hetimit se vendimet e dhëna nga subjekti nuk janë ankimuar nga trashëgimtarët apo persona të tretë; (iii) faktin se trashëgimtarët në këto çështje/palët (në rastin e z. ***) do të ishin po ata dhe do të përfitonin të njëjtat të drejta; (iv) në pikëpamje të zbatimit të ligjit procedural e ligjit të posaçëm, që përcakton rrethin e trashëgimtarëve e të drejtave të tyre, nuk ka diskrecion të gjyqtarit, e po ashtu edhe në rastin e korrigjimit të aktit të gjendjes civile apo rasti i korrigjimit të regjistratit ZRPPP-së (në rastin e z. ***); (v) faktin se vendimet e dhëna nga subjekti nuk kanë prodhuar ndonjë dëm për të tretët apo anasjellas ndonjë favorizim për palët kërkuese; (vi) faktin se marrëdhënia mes subjektit dhe palëve në këto procese gjyqësore ka lindur pasi janë gjykuar çështjet gjyqësore, në të cilat ata ishin palë, pra me një distancë kohore që përjashton mbivendosjen e njëkohshme të ekzistencës së marrëdhënies nga një anë dhe shqyrtimit të një çështjeje me palë personat e përfshirë në marrëdhënie. Në këto kushte, vlerësohet se edhe rrethanat objektive në rastet konkrete vijnë në mbështetje të konkluzionit se nuk ka pasur gjendje të konfliktit të interesit për subjektin e rivlerësimit në gjykimet në fjalë, si dhe nuk janë konstatuar elemente të qenësishme që mund të kenë cenuar etikën magjistratit [...] ³⁶.

12. Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së të datës 19.6.2023, vlerëson se pavarësisht natyrës së çështjeve të gjykuara nga subjekti, është përgjegjësi e tij të mos gjykojë çështje kur ai ka lidhje të natyrës personale apo interesi me palët në gjykim. Subjekti në një numër jo të vogël rastesh si më sipër, ka gjykuar çështje të tilla duke mosrespektuar apo anashkaluar parimet themelore procedurale që synojnë mbrojtjen e paanshmërisë së gjyqësorit. Vlen të theksojmë në veçanti se rasti i vendimit nr. ***, datë ** 4.2010, dhënë për shtetasin ***.***., me objekt: “Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore”, është qartazi një mosmarrëveshje civile me palë kundërshtare, ku subjekti vendosi në favor të të njohurit të tij, situatë e cila, në vlerësimin e Komisionerit Publik duhet të ishte analizuar nga Komisioni në kuadër të integritetit.

12.1 Jurisprudenca e KPA-së mbi të cilën mbështetet Komisioni në vendimmarrjen e tij dhe subjekti në prapësimet e tij, vendimi nr. 42/2022, nuk është relevante me rastin e subjektit, pasi ky vendim referon në një lloj tjetër konflikti interesi. Rasti që referon vendimi nr. 42/2022 **ka të bëjë me** detyrat administrative të një drejtuesi në raport me ligjin nr. 9367/2005, “Për konfliktin e interesit” (i ndryshuar). Ndërsa në rastin e subjektit, z. Hoxha, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me veprimtarinë gjyqësore/procedurale të tij si gjyqtar, rregulluar nga K. Pr. Civile, nenet 72 dhe 73, të tij, si dhe në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale.

12.2 Lidhur me natyrën e vendimeve, nëse ato deklarative duhet të jenë përjashtuese, siç ka pranuar Komisioni në arsyetimin e vendimit, KPA, në vendimin nr. 16/2019, prg. 30.2, ka standardizuar qëndrimin e saj, duke parashikuar se: [...] Në vendimin e Kolegjit nr. 10/2019, është mbajtur i njëjti standard në lidhje me konfliktin e interesit të gjyqtarit. Pretendimi i subjektit se çështja e mësipërme ka qenë konflikt kompetencash dhe nuk ka qenë çështje themeli që duhej të jepte dorëheqjen, nuk gjendet i bazuar në ligj, pasi nuk përjashtohet ligjërisht asnjë çështje, qoftë

³⁶ Referohuni f. 59-60, të vendimit të Komisionit.

kjo e konfliktit të kompetencave që të justifikojë qenien e gjyqtarit në vendimmarrjen e këtyre çështjeve gjyqësore, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit [...].

12.3 Komisioneri Publik vlerëson se marrëdhëniet e subjektit me huamarrësin, z. ***, do të duhej të trajtohej në kontekstin e integritetit, që është pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale, referuar edhe vendimit të KPA-së nr. 3/2020, prg. 33.3³⁷.

III. Konkluzione

13. Nisur nga dispozitat e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, referuar sa ka disponuar Komisioni në rastin konkret, në gjendjen që janë faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, në zbatim të jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt me Komisionin, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

14. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.7.2023, kërkujmë që shkaqet parashtruara në ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 661, datë 18.5.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Hoxha.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

³⁷ “Së fundmi, në rast se do të rezultonte e provuar një marrëdhënie miqësie e ngushtë mes subjektit dhe huamarrësit, palë në procesin gjyqësor, në mungesë të rrethanave që dëshmojnë interes pasuror të përfituar nga subjekti në kushtet e konfliktit të interesit, trupi gjyqësor i Kolegjit vlerëson se kjo lloj situatë do të duhej të trajtohej në kontekstin e integritetit, që është pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale.”